



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 16 Shkurt 2021

Nr: 06

VENDIM

**“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR.03, DATË 11.02.2021 TË
ZOTIT ERION VELIAJ NDAJ VENDIMIT TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE NR.46, DATË 09.02.2021**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 16.02.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijar RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues : Z. Erion Veliaj, përfaqësuar nga Av. Eridian Salianji;

Pala e interesuar: Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj;

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 03 të z. Erion Veliaj me objekt “Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ‘Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj”, të paraqitur në KQZ në datën 11.02.2021.

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020; neni 30, pika 1, shkronja “c” të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020; nenet 17, 18, 19 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet administrative”; neni 3, pika 1, e ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Rrethanat e çështjes:

1. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datat 27.12.2020, 30.12.2020, 05.01.2021 dhe 09.01.2021 janë raportuar disa denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndalura”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) për veprimtaritë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, i cili në llogarinë e tij personale në FACEBOOK, ka publikuar disa foto dhe video me qytetarë të ndryshëm duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore. Kallëzimet e paraqitura nga kallëzuesi ruhen në sistem elektronik dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Kallëzimet e bëra në ndërfaqe/ portal deri me datën 18.1.2021 për këtë subjekt janë si vijon:

1. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 353, datë 30.12.2020
2. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 360, datë 30.12.2020
3. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 362, datë 30.12.2020
4. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 404, datë 05.01.2021
5. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 406, datë 05.01.2021
6. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 562, datë 09.01.2021
7. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 570, datë 09.01.2021
8. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 574, datë 09.01.2021
9. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 578, datë 09.01.2021
10. Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 580, datë 09.01.2021

2. Nisur nga ky raportim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi shqyrtimin e denoncimeve me numër ID të gjeneruar nga sistemi 353, 360, 362 datë 30.12.2021, denoncimeve me numër ID 404, 406 datë 05.01.2021, si dhe denoncimit me numër ID 580 datë 09.01.2021. Në vijim të procedurës administrative ndaj z. Erion Veliaj, me detyrë Kryetar Bashkie Tiranë, dhe pasi shqyrtoi provat e depozituara, në datë 09.02.2021

Komisioneri ka marrë vendimin nr. 46 me të cilin ka vendosur sanksionin administrativ me gjobë, në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për mosraportim të aktiviteteve publike, si dhe sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, në shumën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të nenit 3, paragrafi 1.3, shkronja “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

3. Kundër vendimit nr. 46, datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka bërë ankim z. Erion Veliaj, i cili ka parashtruar se bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, çka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi. Këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t’u konsideruar si veprimtari/aktivitet me karakter publik dhe promovues, pasi nuk janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Të gjitha këto aktivitete, nisur nga vendimi nr. 9/2020, janë zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të familjeve përfituese dhe të një numri shumë të kufizuar të stafit të bashkisë Tiranë. Në asnjë rast nuk kanë qenë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
4. Bashkia Tiranë parashtron se ka dërguar email me objekt “Raportim i veprimtarisë publike të Bashkisë Tiranë” në adresën postare elektronike të vendosur në vendimin nr. 09/2020 (raportime.institucione@kqz.gov.al) për raportimin e aktiviteteve, sepse e kishte të pamundur të aksesonte ndërfaqen. Ky e-mail është kthyer pas, pasi adresa e e-mailit nuk mund të gjendej dhe rezultonte e pasuksesshme.
5. Ankuesi parashtron gjithashtu se asnjë prej banesave të inspektuara përgjatë aktiviteteve, nuk iu është dhënë certifikata e pronësisë; nuk është detyra dhe funksioni i kryetarit të bashkisë dhënia e dokumentit të pronësisë së banesave të dëmtuara. I vetmi dokument i pretenduar ka qenë marrja në dorëzim e punimeve nga kontraktori i punimeve të Bashkia Tiranë, dokument i depozituar si provë nga ankuesi. Për sa më sipër, përfaqësuesi ligjor i ankuesit kërkoi pranimin e ankimit dhe ndryshimin e vendimit nr. 46/2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

6. Pala e interesuar, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj, e gjen vendimin nr. 46, datë 09.02.2021 të KSHZ të bazuar në ligj dhe në prova dhe të marrë në kushtet e një hetimi administrativ të plotë dhe të gjithanshëm. Sipas kësaj pale, bazuar në analizën e fakteve dhe provave, rezulton e paprovuar që bashkia Tiranë të ketë marrë masa aktive për të njoftuar në kohë KQZ-në për raportimin e aktiviteteve publike. Ky mosraportim ngarkon me përgjegjësi administrative Kryetarin e Bashkisë Tiranë.
7. Gjithashtu, nga pala e interesuar LSI u parashtrua se dorëzimi i çelësave të shtëpive, apo dokumenteve të cilësuar publikisht si dokumente pronësie nga Kryetari i Bashkisë z. Veliaj, pavarësisht se nuk janë administruar gjatë procesit aktet shkresore, duke qenë se janë percetuar si “dokumente pronësie” të shtëpive të rindërtuara, përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1.3, shkronja ‘b’ të vendimit nr. 09/20 dhe për këtë shkak, ngarkon me përgjegjësi administrative z. Veliaj.
8. Në këto kushte, pala e interesuar i kërkoi Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve rrëzimin e kërkesës ankimore të subjektit ankues dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 46/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
9. Ankimi iu paraqit Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili caktoi me short si relator z. Koli Bele. Në seancën e datës 12.02.2021, KAS-i me vendimin nr.5, vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 16.02.2021, ora 12:00 dhe vendosi thirrjen në seancë të ankuesit z. Erion Veliaj dhe të përfaqësuesve nga administrata e KQZ-së.
10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Vendimin e Komisionerit Shtetëror të zgjedhjeve nr. 46, datë 09.02.2021;
 - Relacionin për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj z. Erion Veliaj, përparatur nga drejtoria juridike e KQZ-së;
 - Procesverbalin e seancës dëgjimore të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me përfaqësuesin e z. Erion Veliaj;
 - Procesverbalin e mbledhjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për marrjen e vendimit nr. 46, datë 09.02.2021;

- Vendimin nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar me vendimet nr. 51/2020; nr. 22/2020 dhe nr. 46/2020;
- 5 Procesverbale të marrjes paraprake në dorëzim të objekteve të tipologjisë (1+1; 2+1; 3+1);
- Kthim përgjigje e kryetarit të Bashkisë z. Erion Veliaj, nr. 5402, datë 02.02.2021, administruar nga KQZ me nr. 827 prot, datë 03.02.2021, për përcaktimin e të dhënave të kontaktit të personit përgjegjës mbi raportimin e veprimtarive me karakter publik;
- Kërkesa nr. 1234 prot. datë 16.02.2021 mbi parashtrimet e paraqitura nga pala e interesuar Partia Lëvizja Socialiste për Integrim lidhur me ankimin nr. 03, datë 11.02.2021 të z. Erion Veliaj.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin në ndërfaqen raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa pika 5 e këtij vendimi sanksionon se subjektet raportuese mund ta dërgojnë raportimin nëpërmjet e-mail-it zyrtar në adresën raportime.institucione@kqz.gov.al ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.
2. Me shkresën nr. 2616 prot., datë 24.12.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në respektim të kërkesave të këtij vendimi i ka kërkuar Bashkisë Tiranë caktimin e personit të kontaktit me qëllim raportimin e veprimtarive publike. Konfirmimi i personit të kontaktit është dërguar me shkresën nr. 5402 prot, datë 02.02.2021 të Bashkisë Tiranë, administruar në KQZ me shkresën nr. 827 prot, datë 03.02.2021. Sipas kartelës shoqëruese të praktikës (depozituar si provë nga Ankuesi E.Veliaj), në datën 31.12.2020 praktika i është dërguar për ndjekje Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licensimit. Rezulton e provuar se Drejtori i kësaj Drejtorie z. A. Dokushi ka filluar të raportojë në ndërfaqen e KQZ nga data 07.01.2021 e në vijim.

3. Referuar shkresës nr. 5402 prot, datë 02.02.2021 të Bashkisë Tiranë, si dhe në zbatim të nenit 92, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, që përcakton se “*Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)*”, rezulton se Kryetari i Bashkisë Tiranë nuk është personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Tiranë.
4. Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 111/2018 ‘Për kadastrën’, aktet kadastrale janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se dokumentet e pretenduara nga Kallëzuesi LSI, si dokumente pronësie të dorëzuara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, janë procesverbalet e marrjes paraprake në dorëzim të objektit, që mbahen midis palëve që kryejë punimet (Kontraktori, Mbikqyrësi), përfaqësuesve të Bashkisë, si dhe qytetarit që nënshkruan si përfitues i objektit të banimit. Referuar nenit 3 të Vendimit numër 9/2020 të Komisionit Rregullator mbajtja e këtyre procesverbaleve nuk konsiderohet veprimtari e ndaluar. Arsyetimi i Komisionerit se *dorëzimi i dokumenteve të pronësisë së shtëpive të rindërtuara, është “pohuar nga Bashkia Tiranë në infomacionin shpjegues bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2686/1 datë 26.01.2021” dhe në këto kushte jemi para veprimtarive të ndaluara*, nuk rezulton i bazuar në ligj dhe prova.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shumicë votash, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 09.02.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj”;
2. Për pikën 1 të vendimit të KSHZ nr. 46/2021, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar për mosraportim të aktiviteteve publike;
3. Për pikën 2 të vendimit nr. 46/2021, të KSHZ, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të nenit 3, paragrafi 1.3, shkronja “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Koli	BELE	-	Kryesues
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar (Kundër)
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar (Kundër)

Arsyetim plotësues:

Pavarësisht nga vendimmarrja, analiza e KAS-it rreth çështjeve në shqyrtim duhet të plotësohet me disa konstatime, të cilat kanë rëndësi për të qartësuar mangësitë në arsyetimin e çështjes nga Komisioneri dhe për të pozicionuar drejt KAS-in në raport me standardin zgjedhor.

1. KAS-i duhet të analizonte vendimin procedural të Komisionerit për bashkimin e denoncimeve në një hetim të vetëm. Ndonëse Komisioneri ka vepruar drejt kur ka bërë bashkimin e shqyrtimit të denoncimeve në një hetim të vetëm administrativ, metodologjia e hetimit administrativ dhe vendimmarrja nuk mund të bëheshin si për një çështje të vetme. Bashkimi i çështjeve në një hetim të vetëm, nuk duhet të përgjithësojë as hetimin, as masat ndëshkimore. Shkeljet duhet të individualizohen për çdo rast të denoncuar, sikurse sanksionet duhet të vendosen për çdo shkelje.
2. Vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 është akt me karakter normativ, i cili ka hyrë në fuqi me publikimin në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sikurse përcakton neni 14 i tij. Që nga data e publikimit, data 26.12.2020, ky vendim ka qenë detyrues për institucionet shtetërore që ai i ngarkon me detyrimin për raportim. Referenca e Komisionerit tek neni 104 i Kodit të Procedurave Administrative, për të justifikuar hyrjen e mëvonshme në fuqi të tij për Bashkinë Tiranë është e pasaktë. Neni 104 i KPrA trajton hyrjen në fuqi të aktit administrativ individual, i cili, ndryshe nga akti me karakter normativ, hyrjen në fuqi e ka me njoftimin e tij palës, së cilës i drejtohet. KAS-i duhet të korrigjonte këtë vlerësim, jo thjesht për koherencë doktrinale, por sidomos për shkak se Komisioneri mbi këtë bazë ka përjashtuar denoncimet me nr. ID 570, 574, 578 nga hetimi për shkelje të detyrimit për raportim. Ky korrigjim ka sidomos rëndësi për të ardhmen, sepse mund të bëhet strehë për “shkelje” apo “përjashtime” të qëllimshme, duke keqpërdorur dallimin midis akteve që hyjnë në fuqi me publikimin dhe akteve që hyjnë në fuqi me njoftimin palës. Ai ka rëndësi, gjithashtu, për të demonstruar koherencën e domosdoshme të gjykimit që duhet të demonstrojë KAS-i me vendimmarrjen e tij. Në rastin e hetimit administrativ ndaj z. Arben Qalliut (vendimi i KAS-it nr.4, datë 22.01.2021), mbajtja e këtij qëndrimi nga Komisioneri apo KAS-i do kishte çuar në pushimin e çështjes për shkak se zyrtarit në fjalë nuk i ishte dërguar kurrë njoftimi për vendimin nr.9, datë 24.12.2021 të Komisionit Rregullatorit.
3. Komisioneri ka analizuar drejt kur ka konstatuar se dërgimi mediave i materialit të përgatitur prej vetë Bashkisë së Tiranës, përmes zyrës së shtypit të këtij institucioni dhe jo postimi në llogarinë e FACEBOOK-ut vërteton qëllimin e informimit të publikut nëpërmjet medias për veprimtaritë e zhvilluara dhe i shndërron ato në veprimtari publike, të cilat duhet të raportohen,

pavarësisht se veprimtaritë nuk kanë pasur pjesëmarrjen e publikut apo të medias në momentin kur janë zhvilluar. KAS-i me vendimmarrjen e tij e ka mbështetur këtë konstatim. Gjithësesi, roli i postimit në median sociale dhe vlera e tij për identifikimin e qëllimit informativ të veprimtarisë duhet të ishin analizuar nga Komisioneri dhe KAS-i në detaj. Postimi në mediat sociale i fotove, videove apo komenteve rreth veprimtarive, nuk i bën veprimtaritë që të cilësohen automatikisht publike në këndvështrim të përkufizimit të pikës 1 të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në një shumicë rastesh postimet ndjekin qëllime të ndryshme nga qëllimi për informim që kërkon pika 1 e nenit 92 të Kodit. Në një shumicë rastesh postimet synojnë të promovojnë mbajtësin e llogarisë, apo çështje që janë të rëndësishme për të, të shfaqin qëndrime apo opinione, të ngrenë probleme a të sensibilizojnë, të nxisin diskutime apo të debatojnë. Në çështjen objekt shqyrtimi, ilustrimin për këtë qëndrim e jep mjaftueshëm qartë denoncimi i referuar me nr. ID 570. Ky rast përfshin një postim të Kryeministrit Edi Rama me shënimin: “MIRËMËNGJES! dhe me disa nga shtëpitë e rindërtuara në Tiranë, ndërkohë që rikthimi në banesa të reja vijon çdo ditë për të prekurit nga tërmeti, ju uroj një të dielë të qetë”. Postimi shoqërohet me video me pamje nga inspektime/takime të papërcaktuara të kryera nga Kryeministri, me në sfond muzikë të huaj sensuale. Ky postim nuk mund të cilësohet veprimtari publike, pamjet nga veprimtari të papërcaktuara që shfaqen në video nuk i bëjnë dot veprimtaritë që të cilësohen, për këtë shkak, publike dhe Kryetari i Bashkisë Tiranë nuk mund të bëhet përgjegjës për mosraportim veprimtarish, vetëm për shkak se imazhi i tij shfaqet në postimin përshëndetës të Kryeministrit.

4. Denoncuesi e ka mbështetur denoncimin e tij në fotot dhe videot e postuara në llogarinë e FACEBOOK-ut të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, kurse Komisioneri e ka mbështetur vendimin në të dhënat e përfutuara nga hetimi pranë një numri të caktuar mediash të shkruara ose televizive. KAS-i duhet të saktësonte, se për të provuar karakterin publik të veprimtarive të denoncuar ka rëndësi vetëm materiali që i ka komunikuar medias zyra e shtypit e Bashkisë Tiranë, pavarësisht nëse media e ka publikuar atë, ose jo. Komunikimi nga zyra e shtypit në drejtim të medias formon provën për qëllimin informues të veprimtarisë. Ekzistenca e qëllimit informues e bën veprimtarinë publike, për pasojë të detyrueshme për raportim. Ky saktësim është i rëndësishëm, sepse denoncimet e ngjashme në të ardhmen, kërkimin e provës duhet t’u orientojnë në këtë drejtim.
5. Komisioneri ka gjetur fajtor Kryetarin e Bashkisë Tiranë për kryerjen e “veprimtarive të ndaluara në kuptim të nenit 3, pika 1.3 shkronja “b” të vendimit nr. 9/2020”, sepse përgjatë

veprimtarive të denoncuara ai ka bërë dorëzim të dokumenteve të pronësisë së shtëpive të rindërtuara. Konstatimin e faktit juridik Komisioneri e ka bërë bazuar në pohimin e Bashkisë Tiranë në informacionin shpjegues bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2686/1 datë 26.01.2021. Dokumenti i referuar më sipër përmban shpjegimin se janë dorëzuar “çelësat e banesave” për rastet e referuara nga denoncimet me nr. ID 574, 353 dhe 404, sikurse përmend “dokumentet e shtëpisë” ose “dokumentet e pronësisë” në rastet me nr. ID 574 dhe 362. Nga këqyrja e materialeve video nga llogaria e FACEBOOK-ut e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, rezulton se Kryetari i bashkisë u ka prezantuar përfituesve të banesave “shkresa për firmë” “të nevojshme për të marrë dokumentet e pronësisë” në rastet e denoncuara me nr. ID 362, 404, 406, 562, 578 dhe 580, sikurse ka vendosur shënimin “sot, i dorëzuar edhe dokumentet e pronësisë së shtëpisë”, shoqëruar me foto të përfituesit duke nënshkruar mbi shkresa, në postimin me nr. ID 360, i cili i referohet të njëjtës ngjarje me atë të rastit me nr. ID 362. Numri total i praktikave të Identifikuara, ku përfituesit janë ftuar të “hedhin firmën” mbi dokumente është 13, ndërkohë që numri real i praktikave “për firmë” është dukshëm më i madh. Përpara se të vendoste masë administrative për shkelje të kësaj dispozite, Komisioneri duhet të kishte administruar dhe vlerësuar të ashtuquajturat “dokumente pronësie” dhe jo të mbështetej vetëm në deklaratimet e palëve. “Dokumentet e pronësisë” që referohen në shkresën informative të bashkisë dhe shkresat që shfaqen në materialin video të postuar në llogarinë në FACEBOOK të Kryetarit të Bashkisë Tiranë janë depozituar nga Bashkia Tiranë në dosjen hetimore të KQZ-së. Ato janë 6 dokumente që titullohen “Procesverbal i marrjes paraprake në dorëzim të objektit të tipologjisë 1+1 (2+1) (3+1)” Ato i referohen 5 praktikave që kanë lidhje me rastet e referuara me nr. ID 360 (362) (Mehmet Deliu), 404 (Hekuran Balla), 406 (Bajram Karaj), 578 (Qani Merepeza) dhe 580 (Hider Dani), por nuk mbulojnë totalin e praktikave të identifikuara nëpërmjet këqyrjes së regjistrimeve video të denoncuara nga llogaria në FACEBOOK e Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Gjithësesi, vlerësimi i KAS-it se dokumentet “Procesverbal i marrjes paraprake në dorëzim të objektit të tipologjisë 1+1 (2+1) (3+1)” që u administruan janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin, se dokumentet e përfolura nuk janë “certifikata pronësie” dhe as dokumente të ngjashme me to është i drejtë. Mungesa e faktit juridik (dorëzimi i certifikatave të pronësisë) bën të paqenë shkeljen, për pasojë, bën të paligjshme vendosjen e sanksionit administrativ.

6. Analiza ligjore e KAS-it për subjektin që mban përgjegjësi për raportimin e veprimtarive publike sipas nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar është gjithashtu e saktë. Kryetari i Bashkisë nuk mund të thirret në përgjegjësi administrative për mosraportim. Sipas pikës 6 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor

“mosraportimi (...) ose zhvillimi i tyre (veprimtarive), pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi (...) titullarin përkatës të institucionit **kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite**”. Kryetari i Bashkisë Tiranë mund të thirret në përgjegjësi administrative vetëm kur ka penguar raportimin ose kur ka lejuar zhvillimin e ndonjëres prej veprimtarive, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja. Përgjegjësitë janë të individualizuara, shkeljet janë të specifikuar dhe zëvendësimi i subjektit të shkeljes nuk lejohet nga ligji. Në çështjen objekt shqyrtimi nuk është bërë denoncim, si dhe nuk ka pasur të dhëna nga hetimi që të provonin kryerjen e shkeljes sipas pikës 6 të nenit 92 nga Kryetari i Bashkisë Tiranë. Mungesa e shkeljes bën të paligjshme vendosjen e sanksionit administrativ.

7. Hetimi provoi se shumica dërrmuese e denoncimeve për veprimtari publike të pa raportuara i përkasin periudhës kur Bashkia Tiranë nuk e kishte caktuar ende personin përgjegjës për raportimin. Llogaria e raportimeve për Bashkinë Tiranë është bërë efektive duke filluar nga data 07.01.2021 (me 12 ditë vonesë), ndërkohë që komunikimi shkresor është përcjellë vetëm më datë 02.02.2021, me shkresën nr. 5402 prot, drejtuar KQZ-së (me 38 ditë vonesë). Moscaktimi i personit përgjegjës është përgjegjësi që bie mbi Kryetarin e Bashkisë Tiranë, si titullar i institucionit. Detyrimi dhe përgjegjësia janë të identifikueshme qartë dhe të ndryshme nga detyrimi dhe përgjegjësia për raportimin e veprimtarive. Moscaktimi i personit përgjegjës për periudhën e sipërcituar formon shkelje të detyrimit sipas pikave 1 dhe 2 (mekanizimi i raportimit) të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, subjekt i shkeljes është Kryetari i Bashkisë Tiranë (titullari i institucionit-kompetent për ngritjen e mekanizimit) dhe shkelja është e dënueshme sipas pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor (shkelje nga personi i ngarkuar me detyra). Në këto kushte, KAS-i nuk mund t’u trajtonte rastin si “rast faktor” (të mos gjente as shkelje dhe as të mos identifikonte fajtorë), ose, përndryshe të gjente shkelje dhe të mos identifikonte fajtorë. Hetimi administrativ me shkelje dhe pa fajtorë është hetim i pambyllur.
8. Bashkia Tiranë është vonuar, nga hyrja në fuqi e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, 12 ditë për të marrë akses tek llogaria e raportimeve dhe 38 ditë për të përcjellë zyrtarisht emrat e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive. Mekanizmi i raportimeve ka vlerë vetëm për katër muajt që i paraprijnë datës së zgjedhjeve. Vonesa prej 12 apo 38 ditësh brenda kësaj periudhe të shkurtër është një kohë e gjatë, e cila dëmton veprimin e mekanizmit, krijon avantazh të padrejtë për shkelësin, cënon barazinë e armëve dhe nxit mosbesim tek veprimi i ligjit. KAS-i duhet t’u bënte këtë konstatim, sepse vetëm kështu ai vendos masën e drejtë të vlerësimit për çdo moskryerje tjetër apo vonesë tjetër në

kryerjen e detyrave sipas Kodit, për KQZ-në dhe për të gjithë personat apo institucionet e ngarkuara me detyra dhe detyrime.

9. Hetimi i KAS-it duhet të ndalej edhe në identifikimin e shkaqeve apo faktorëve që kanë ndikuar mbi Kryetarin e Bashkisë për mospërmbushjen në kohë të detyrës. Këtë e kërkon objektiviteti dhe paanësia në gjykim, por edhe nevoja për të përcaktuar, eventualisht, sanksionin e përshtatshëm administrativ. Në këtë kuadër, KAS-i duhet të njihte dhe pranonte faktin se vendimi nr.9, datë 24.12.2020 i Rregullatorit ka hyrë në fuqi vetëm më datë 26.12.2020, ditën kur ka filluar afati 4 mujor i raportimit. Kjo gjë ka vështirësuar objektivisht ngritjen e mekanizmave raportues dhe ka shkaktuar një përplasje të paevitueshme midis detyrimit për raportim dhe mungesës së mekanizimit raportues. Gjithashtu, KAS-i duhet të konstatoje se administrata e KQZ-së nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të detyruar Bashkinë Tiranë që t'i përgjigjej me shpejtësi detyrës dhe të mos bëjë pengesë për veprimin korrekt të mekanizimit ligjor të raportimit. KQZ-ja ishte në dijeni si të faktit, se ndaj Kryetarit të Bashkisë po vinin denoncime për mosraportim, ashtu edhe të faktit se Kryetari i Bashkisë nuk kishte caktuar ende personin përgjegjës për raportimin. Nga ana tjetër, në disavantazh të Kryetarit të Bashkisë flet fakti, se denoncimet bëhen në ndërfaqe, me qëllim që ato të jenë publike dhe palët e interesuara të vihen menjëherë në dijeni. Si institucion i ngarkuar me detyra në fushën e raportimit, Bashkia Tiranë, duhet ta konsultojë ndërfaqen në intervale të përditshme, pa pasur nevojë që të sensibilizohet nga ana e KQZ-së, si dhe duhet t'i kushtojë mekanizimit të raportimit vëmendje dhe përkushtim të posaçëm. Kjo vëmendje dhe ky përkushtim kanë munguar deri më datë 07.01.2021.
10. Pavarësisht vërejtjeve ndaj arsyetimit të shumicës, vendimi i Komisionerit nr. 46, datë 09.02.2021 duhet të shfuqizohet në të dy komponentët e tij, sepse Kryetari i Bashkisë Tiranë, nuk është personi ligjërisht përgjegjës për raportimin e aktiviteteve publike të Bashkisë Tiranë, si dhe sepse në veprimtaritë e kryera prej tij provohet se nuk janë shpërndarë certifikata pronësie. Kjo vendimmarrje qëndron, pavarësisht se KAS-i nuk arriti të sigurojë shumicë arsyetuese dhe vendimmarrëse lidhur me përgjegjësinë administrative të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për moscaktimin e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, me hyrjen në fuqi të vendimit nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Ilirjan RUSMALI Anëtar



MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 3 të paraqitur nga z. Erion Veliaj me objekt *“Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 46, datë 09.02.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj.....”*, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të refuzonte ankimin e z. Veliaj dhe për rrjedhojë të linte në fuqi vendimin nr. 46, datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.

2. Lidhur me ankimin ndaj sanksionit të parashikuar në pikën 1 të vendimit objekt ankimi, ne anëtarët e pakicës vlerësojmë se *“përgjegjësia e Kryetarit të bashkisë në procesin e raportimit në ndërfaqen e KQZ të aktiviteteve të parashikuara për tu zhvilluar”* në kuptim nenit 92 pika 1 të Kodit Zgjedhor¹ dhe të neneve 2 dhe 4 të vendimit nr. 9/2020 *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”* të Komisionit Rregullator (në vijim vendimi nr. 9/2020), duhet parë dhe vlerësuar në një këndvështrim më të gjerë dhe sipas interpretimit qëllimor të tij dhe jo atij literal. Në rastin konkret mosraportimi në kohë i aktiviteteve të zhvilluara nga Bashkia e Tiranës në KQZ (qoftë nëpërmjet ndërfaqes, qoftë nëpërmjet metodave tradicionale të komunikimit zyrtar) është pasojë e një kompleksiteti veprimesh të kryera në moszbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim. Në këtë kontekst edhe përgjegjësia për moszbatimin e ligjit në këtë rast është gjithashtu komplekse. Është i vërtetë fakti se raportimi i mirëfilltë në KQZ është detyrë specifike e personit të ngarkuar me këtë detyrë nga titullari i autoritetit shtetëror, por është gjithashtu i vërtetë edhe fakti se në rastin objekt vlerësimi, titullari i institucionit (kryetari i bashkisë) nuk ka zbatuar detyrimet e tij ligjore në përcaktimin e personit përgjegjës, i cili më pas do të mbartte detyrimin për të raportuar aktivitetet e institucionit në KQZ. Në këtë kontekst, pyetja që shtrohet në këtë rast është: nëse mundësohet ndarja e saktë e përgjegjësisë së titullarit të institucionit me atë të personit të ngarkuar me raportimin në KQZ?! Ose: a mund të ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për raportimin me KQZ, ndërkohë që ky person ende nuk është caktuar nga kryetari i bashkisë, për më tepër duke neglizhuar një urdhëresë ligjore?

¹ *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.*



3. Pra është evident fakti se përpara se të ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës për mosraportimin e aktiviteteve të Bashkisë Tiranë në KQZ, duhet evidentuar përgjegjësia e kryetarit të bashkisë në mospërcaktimin e këtij personi, mosveprim i cili është në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Pra, z. Veliaj edhe pse *prima facie* duket sikur nuk ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë në mosraportimin e aktiviteteve të Bashkisë Tiranë në KQZ, por me mosveprim, ka përgjegjësi të tërthortë në këtë kundërvajtje administrative, përgjegjësi e cila konsiston në mosemërimin pa asnjë arsye të ligjshme të personit përgjegjës, mosveprim i cili ka sjellë më pas si pasojë të drejtpërdrejtë cënimin nga institucioni i Bashkisë Tiranë të dispozitave ligjore dhe standardeve të vendosura në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Përgjegjësia e ankimuesit në lidhje me mospërcaktimin e personit të kontaktit dhe mosraportimit të aktiviteteve publike në KQZ në zbatim të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, vihet re dhe nga vetë qëndrimi i mbajtur në ankimin ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Më konkretisht, në ankim citohet se *“Po kështu, për sa i përket përgjigjeve të marra nga mediat, lidhur me raportimin prej tyre të këtyre aktiviteteve, ftesa për publikim është realizuar përmes zyrës së shtypit të bashkisë dhe konkluzionit të arritur në relacionin e administratës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve se pretendimi i Bashkisë Tiranë se ky aktivitet nuk ka pasur qëllim informimin e publikut, vlerësojmë se gjendet i pabazuar dhe i mbështetur në respektim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020 dhe nuk qëndrojnë. Ashtu siç argumentuam dhe më sipër, në asnjë rast aktivitetet e kallëzuara nuk kanë qenë të hapura për publikun dhe pjesëmarrjen e medias. Ftesa për publikim dhe marrja e këtij informacioni nga llogaria në Facebook, është totalisht e ndryshme dhe e dallueshme nga veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe të medias. Ftesa që iu është bërë mediave për raportimin e këtyre aktiviteteve sipas arsyetimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të mbështetur në korrespondencën e zhvilluar midis këtij të fundit dhe përgjigjeve të disa mediave, është totalisht e ndryshme nga pjesëmarrja e tyre në aktivitet. Ftesa për publikim është një ftesë e cila vlerësohet nëse do të transmetohet apo jo nga vetë mediat e ndryshme”*.

Vetë fakti që ankimuesi pranon se ka njoftuar mediat nëpërmjet zyrës së shtypit që është në varësi të tij e po ashtu që ka dështuar në caktimin e personit përgjegjës për marrëdhëniet me KQZ në lidhje me raportimin e aktiviteteve publike, tregon qartazi vullnetin e tij për të mos respektuar nenin 92 të K. Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Interpretimi i ankimuesit se ftesa që i është bërë mediave për raportimin e këtyre aktiviteteve *post* kryerjes së tyre është e ndryshme nga pjesëmarrja e tyre (mediave) në aktivitet, është një interpretim absurd dhe krejtësisht i pabazuar në K. Zgjedhor dhe vendimin nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Ne anëtarët e pakicës, mbajmë qëndrimin që pavarësisht momentit të transmetimit (në kohë reale apo pas zhvillimit të aktivitetit), nëse një nga subjektet e përcaktuara në K. Zgjedhor dhe aktet

nënligjore të dala në zbatim të tij, njofton mediat në lidhje me zhvillimin e një veprimtarie, atëherë veprimtaria do të konsiderohet “veprimtari publike” në kuptim të nenit 2 shkronja “b” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Çdo interpretim tjetër do të binte ndesh me frymën e K. Zgjedhor dhe qëllimin e miratimit të nenit 92 të këtij kodi nga ligjvënësi.

5. Në këtë kontekst, z. Veliaj, duke vijuar me njoftimin e mediave për veprimtaritë që kryente në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, si dhe duke mos përcaktuar personin përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në KQZ e për rrjedhojë duke mos i raportuar këto veprimtari publike, ka konsumuar kundërvajtjen administrative të përcaktuar në nenin 92 pika 1, 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor dhe për këtë arsye ai duhet të dënohet administrativisht me gjobë në zbatim të pikës 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor. Përgjegjësia e tij, përveçse sa më sipër theksohet edhe nga parashikimi në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, i cili në nenin 64 shkronja “gj” parashikon konkretisht se “*Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra: ... gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët*”. Po ashtu, qëllimi i tij për të mos njohur detyrimet që bashkia që drejtohet prej tij ka ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duket dhe në mungesën e përcaktimit në kohë të personit përgjegjës për raportimet e veprimtarive publike në KQZ edhe pse vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator ka hyrë në fuqi që në datë 26.12.2020, por po ashtu është njoftuar me shkresën nr. 2616 prot., datë 24.12.2020 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Bashkia Tiranë, ka konfirmuar personin e kontaktit në lidhje me detyrimin e sipërcituar pas një periudhe më shumë se një muaj me shkresën nr. 827 prot., datë 03.02.2021. Një qasje kundërshtuese ndaj KQZ dhe ndaj zbatimit të K. Zgjedhor dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij e ankimesit vihet re dhe në informacionin e shpërndarë nga Drejtoria e Informacionit e Bashkisë Tiranë për mediat në datë 07.01.2021 ku ndër të tjera citohet “*Ajo që po ndodh me kakofoninë e një vendimi të KQZ-së është shqetësuese sepse nuk mund të ketë dy rregulla: një për këtë anë të kodrës, ku jetojnë fukarenjtë, dhe një për anën tjetër të Farkës, ku jetojnë pasanikët. ... KQZ-ja s’mund të jetë tryezë analistësh, por duhet t’i bëjë të qarta rregullat. ... Kryebashkiaku i Tiranës nënvizoi se KQZ-ja duhet ta qartësojë një herë e mirë këtë çështje. “Është shumë e rëndësishme që të kalojmë nga një KQZ që bën analistin, në një institucion serioz, që nuk bën analiza që kalojnë mbi ligjin. Ka ligj për pushtetin vendor. Ka ligj mënyra si funksionojmë. Ka ligj që kërkon që t’i bëjmë këto pune”*”.

6. Për ne anëtarët e pakicës, është i paqartë arsyetimi plotësues i vendimit të shumicës në lidhje me përgjegjësinë administrative të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për mosaktimin e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, pasi një arsyetim i tillë më shumë duket si plotësues i mendimit të pakicës se sa i mendimit të shumicës. Ky qëndrim më së shumti duket sikur në rastin më të mirë krijon një shumicë për lënien në fuqi të dënimit administrativ me gjobë të sanksionuar në pikën 1 të dispozitivit

të vendimit objekt shqyrtimi administrativ sipas pikës 3 të nenit 137 të K.Pr.Administrative² apo në rastin më të keq nuk krijon një shumicë³ në zbatim të nenit 21 pika 3 të K. Zgjedhor për ndryshimin dhe shfuqizimin e dënimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në lidhje me këtë shkelje.

7. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, por edhe nga ai i zhvilluar në KAS u provua plotësisht fakti se z. Erion Veliaj, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ka zhvilluar disa veprimtari publike të ndaluara nga K. Zgjedhor në kuptim të nenit 92 të tij dhe nga vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator në kuptim të nenit 3 pika 1.3 shkronja “b” të tij. Po ashtu u provua se në informacionin e përcjellë nga zyra e shtypit e Bashkisë Tiranë në media si edhe në videot e publikuara nga vetë z. Veliaj në faqen e tij në *Facebook*, është deklaruar në shumicën e rasteve se personave përfitues të banesave u janë dhënë “dokumentet e pronësisë”, pa specifikuar në fakt llojin apo emrin e këtyre dokumenteve. Më konkretisht, në informacionin sqarues që ankimesi Erion Veliaj i ka bashkëlidhur shkresës me nr. 2686/1 prot., datë 26.01.2021 drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ai vetë citon se:

“2. ... INFO: **Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, ministri i Shtetit për Rindërtim, z. Arben Ahmetaj dhe Prefekti i Tiranës, z. Toni Gogu, dorëzuan dokumentet e pronësisë së banesave të rindërtuara familjeve të Qani Merepezës, Ibrahim Myrtës dhe Rifat Myrtës në Pezë.** ...

4. ... INFO: **Dashamir Paci, Ylli Troksi dhe Muhamet Deliu morën në duar dokumentet e pronësisë së banesës së saporindërtuar nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj ...**

6. ... INFO: **Dy familje në Zall-Her; banesat e të cilëve u dëmtuan nga tërmeti kanë marrë çelësat e shtëpive të reja ...**

7. ... INFO: ... **Pas tërmetit shkatërrues të një viti më parë, familjet e Hider Danit dhe Dan Danit nga fshati Çerkezë e Zall Herrit, morën pronësinë e banesës së rindërtuar. ...**

8. ... INFO: **Famija e Bajram Karajt, nga fshati Balshaban në Baldushk, morën shtëpinë e re, një vit pasi shtëpia iu shkatërrua nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. ...**

9 ... INFO: ... **Hekuran Balla, Shyqeri Shabani dhe Alfred tresa nga fshati Balshaban morën çelësat e banesave të reja nga kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. ...**

10. ... INFO: **Kryebashkiaku vizitoi familjet e Ramazan Memës dhe Mariglen Ballës në Farkë, të cilat hynë në shtëpitë e reja, të saponërtuara. ...”**

² “Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese e aktit administrativ të ankimuar është e ligjshme, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai refuzon ankimin dhe paraqet arsyetimin e ri”.

³ “Aktet administrative bazë të KAS-it janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë ...”

Më shumë se një herë, në vetë informacionin që ankimesi Erion Veliaj i ka dërguar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pranon se ka “shpërndarë dokumente pronësie”, “ka dorëzuar çelësa shtëpie” apo “që ka qenë i pranishëm kur familjet sapo kanë hyrë në shtëpitë e reja”.

8. E njëjta qasje është ndjekur edhe nga Drejtoria e Informacionit pranë Bashkisë Tiranë e cila në njoftimet për mediat, veprimtaritë e ankimesit Erion Veliaj, i konsideron si “... njoftimin e Kryetarit Veliaj, i cili i dha çelësat e tre shtëpive të reja në Baldushk” apo “... njoftimin e Kryetarit Veliaj, i cili së bashku me ministrin Ahmetaj, i dorëzuan dokumentet e pronësisë disa familjeve që iu rindërtuan shtëpitë në Njësinë Pezë”. Pra duket qartë që Bashkia Tiranë si ndaj palëve të treta (KQZ), por po ashtu dhe ndaj mediave, është konstante në qëndrimin se shpërndan dokumente pronësie apo dorëzon çelësa shtëpie.

9. Nga hetimi administrativ i bërë nga KAS, rezultoi se dokumentet në fjalë (sipas atyre që pala ankimese ka depozituar në mbrojtje të pretendimeve të saj) janë “Procesverbal i marrjes në dorëzim paraprak të banesës”, dokumente të nënshkruara nga përfaqësuesi i bashkisë, përfaqësuesi i subjektit ndërtues dhe nga një përfaqësues i familjes përfituese të banesës. I pyetur nga KAS në seancën publike të datës 16.2.2021 lidhur me qëllimin e nënshkrimit të këtij dokumenti si edhe për vlerën ligjore të këtij dokumenti, përfaqësuesi ligjor i ankimesit dështoi të jepte shpjegime të qarta dhe shteruese për këtë fakt, çka krijon një dyshim të arsyeshëm se emërtimi (gjatë kronikave në TV dhe në rrjetin social Facebook) i këtyre dokumenteve pa ndonjë vlerë të qartë ligjore si “dokumente pronësie” është bërë i qëllimshëm për të krijuar në publik idenë dhe perceptimin apo për të përcjellë mesazhin se “Kryetari i bashkisë po shpërndan dokumentet e pronësisë së shtëpive të ndërtuara”, kur në fakt kjo nuk ishte e vërtetë. Në këtë kontekst lind dyshimi i arsyeshëm se ky veprim është kryer për qëllime zgjedhore dhe jo për qëllime transparence ndaj publikut sikundër pretendohet nga ankuesi. Këto aktivitete përbëjnë aktivitete të ndaluara në kuptim të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ për të cilën mban përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Tiranë.

10. Pavarësisht faktit se në nenin 3 paragrafi 1.3 shkronja “b” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, në mënyrë që kundërvajtësi të ngarkohet me përgjegjësi administrative për shkeljen e kësaj dispozite, kërkohet ndër të tjera që të shpërndahen specifikisht dokumente të tipit “çertifikata pronësie”, dhe dokumentet e shpërndara *de facto* nuk kanë ekzaktësisht atë emërtesë, kjo nuk e përjashton z. Veliaj nga përgjegjësia administrative.

11. Sipas interpretimit teleologjik (qëllimor) të kësaj dispozite, neni 3 paragrafi 1.3 shkronja “b” e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, në fakt ka për qëllim ndalimin e shpërndarjes të dokumenteve të tilla, të cilët tek përfituesit apo edhe tek publiku që lexon apo shikon kronikat nëpër gazeta a televizione, krijojnë perceptimin se janë dokumente që (sidomos kur lëshohen nga punonjës të

veshur me autoritet publik), kanë/marrin një cilësi të veçantë, si për shembull atë të fitimit të një të drejte pronësie mbi një send të paluajtshëm, çka krijon tek ata (përfituesit dhe publiku) perceptimin se ky proces mund të bëhet vetëm nga administrata shtetërore dhe drejtuesit e saj dhe nga askush tjetër. Ky në thelb është edhe përfitimi zgjedhor apo thënë ndryshe “konkurrenca e pandershme” që kjo dispozitë ka për qëllim të shmangë.

12. Në këtë kontekst, ankimesi duke krijuar në publik idenë se po shpërndan “*dokumente të një cilësi të veçantë, me anë të të cilëve fitohet një e drejtë pronësie mbi një send të paluajtshëm*”, ka kryer një aktivitet të ndaluar në kuptim të shkronjës “b” të paragrafit 1.3 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator të KQZ, për të cilën ai duhet të ngarkohet me përgjegjësi administrative.

13. Interpretimi literal që anëtarët e shumicës i bëjnë nenit 3 pika 1.3 shkronja “b” të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në lidhje me termin “*dokument pronësie*”, bie ndesh me frymën e ndryshimeve në K. Zgjedhor me ligjin nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe me qëllimin e partive politike për vendosjen e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor. **Për ne anëtarët e pakicës, fakt juridik për konsumimin e kësaj kundërvajtjeje administrative nuk është dorëzimi i certifikatave të pronësisë siç argumentohet në arsyetimin plotësues të vendimit të shumicës së anëtarëve, por deklarimi në një veprimtari publike se po shpërndahen “dokumente pronësie”.**

Madje ky është thelbi i shkeljes dhe në rastin objekt shqyrtimi mund të konsiderohet edhe në kushtet e rrethanave rënduese pasi edhe pse realisht nuk po shpërndahen “certifikata pronësie”, publikut po i “shiten” si të tilla. Është e pakonceptueshme që të mendohet se ankimesi, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, të mund të mos arrijë të bëjë dallimin mes një “procesverbali dorëzimi” dhe një “certifikate pronësie”.

14. Ne anëtarët e pakicës, vijojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim në lidhje me publikimin në rrjete sociale, më konkretisht nëse publikimet në llogaritë në rrjetin social *Facebook*, konsiderohen apo jo veprimtari publike. Për ne anëtarët e pakicës, qëndrimi i mbajtur në arsyetimin plotësues të vendimit të shumicës së anëtarëve, është një qëndrim që bie ndesh me nenin 92 të K.Zgjedhor, pasi së pari përdorimi i rrjeteve sociale patjetër që ka në agjendë informimin e publikut rreth kësaj veprimtarie (shpërndarja e dokumenteve të pronësisë në rastin objekt shqyrtimi) që është një nga kushtet e mjaftueshme për ta

kualifikuar një veprimtari si publike, por së dyti bie ndesh dhe me interpretimin teleologjik (qëllimor) që i bëhet nenit 92 të K.Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në lidhje me vendosjen e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. **Për më tepër, në kushtet që “periudha katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve” me shumë mundësi do të vijojë të karakterizohet nga masat anti COVID-19, atëherë kjo e bën dhe më masive përdorimin e rrjeteve sociale, çka do të thotë se moskonsiderimi i përdorimit të tyre si “veprimtari publike”, do t’i shndërronte dispozitat e sipërcituara si të pazbatueshme dhe për rrjedhojë nuk do të arrihej synimi për garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor.** Në arsyetimin plotësues të vendimit të shumicës vihet re që në lidhje me moskonsiderimin e publikimeve në rrjetin social *Facebook* si me qëllim informimi, rast ilustrimi merret një nga denoncimet e bëra nga subjekti Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, por ndërkohë për ne anëtarët e pakicës, analiza për publikimet në rrjetet sociale duhet të bëhet rast pas rasti dhe për çdo denoncim pasi qëllimi për informim i publikimeve në rrjete sociale nuk mund të bëhet mbi baza ilustrative apo *apriori*, por vetëm duke analizuar çdo rast në mënyrë të detajuar. Nuk është imazhi ai që e shndërron një postim në rrjete sociale si mënyrë informimi, por përmbajtja e publikimit. Nëse përmbajtja e publikimit është e tillë që arrin të përçojë nëpërmjet fjalëve dhe/ose figurave një mesazh konkret informues, për ne anëtarët e pakicës, i plotëson kushtet e “veprimtarisë publike” pasi i shërben agjendës së informimit të subjekteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionerit Rregullator.

15. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimuesi Erion Veliaj është e pabazuar dhe ajo duhet të ishte rrëzuar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte lënë në fuqi vendimi nr. 46, datë 09.02.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Elvis ÇEFA Anëtar

Ledio BRAHO Anëtar

